

Intervistë e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorit Pavel Vacek

Gazetare: Blerina Gjoka

Zyra e Prezencës së OSBE-së e përshëndeti menjëherë idenë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, i cili nuk është ngritur ende. Si po i lexon zyra juaj debatet midis partive të mëdha dhe aleatëve të tyre për çështjen e vetos?

E rëndësishme është që këto debate mes partive politike zhvillohen pa pasur nevojën e një përfshirjeje të jashtme dhe kështu duhet të vazhdojë të jetë. Megjithatë, e mira është që Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore të jetë në gjendje të fillojë nga puna. Dhe kur të ndodhë kjo, OSBE-ja -- si ODIHR-i ashtu edhe Prezenca e OSBE-së -- të mund t'i ofrojnë këtij komisioni ekspertizën dhe mbështetjen e tyre teknike.

Sipas një marrëveshjeje mes dy partive të mëdha, u vendos që të mos prekej Kushtetuta. A rekomandon OSBE-ja që reforma të marrë parasysh edhe ndryshimin e Kushtetutës për disa çështje që kanë hapur debate të mëdha politike, siç është sistemi zgjedhor apo zgjedhja e Presidentit të Republikës?

Në lidhje me këtë, rekomandimet e OSBE/ODIHR-it nuk janë urdhëruese. Zgjedhjen për mënyrën se si do procedohet e kanë në dorë aktorët politikë shqiptarë, pra, nëse ata dëshirojnë të zgjedhin një rishikim të plotë të sistemit zgjedhor që tani, apo dëshirojnë të merren me çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet e ardhshme për pushtetin vendor si perparësi. Është një gjë e mirë që Komisionit i është ngarkuar të marrë parasysh rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet e vitit 2005. Por janë edhe rekomandimet e mëparshme, përfshi këtu rekomandimet e përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2004, që, për një arsye apo një tjetër, nuk janë marrë parasysh plotësisht ose aspak. Ka një rekomandim më të hershëm të ODIHR-it për thjeshtimin e sistemit zgjedhor. Çështjen nëse sistemi zgjedhor duhet ndryshuar apo jo raporti i i vitit 2005 i ODIHR-it ia lë në dorë aktorëve politikë shqiptarë. Një ndryshim i sistemit zgjedhor do të kërkonte ndryshimin e Kushtetutës dhe kjo, kuptohet, nuk është një gjë e lehtë.

Cili është roli i OSBE-së në procesin e ri për reformën zgjedhore?

Bashkë me ODIHR-in, ne do t'i sigurojmë Kuvendit, nëse kjo do të na kërkohet, asistencë teknike dhe ekspertizë. Ashtu si në të kaluarën, asistencë do të jepet për të përmirësuar legjislacionin për zgjedhjet në përputhje me angazhimet e OSBE-së, rekomandimet e ODIHR-it dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. E theksoj se nuk jemi ne ata që garantojmë që kjo gjë të ndodhë. Kjo mbetet gjithmonë në dorë të aktorëve politikë shqiptarë.

Cilat janë sipas jush çështjet më emergjente me të cilat duhet të merret Komisioni i ri? A ka diçka që duhet përmirësuar lidhur me zgjedhjet e ardhshme vendore?

Unë besoj se pala shqiptare ka nxjerrë mësim të mjaftueshëm për të kuptuar se me çfarë duhet të fillojë të merret Komisioni i Posaçëm dhe, natyrisht, zgjedhjet e ardhshme vendore mbeten përparësi. Por nëse ju këmbëngulni, unë mund të përmend disa gjëra që rrjedhin nga

vëzhgimi i zgjedhjeve në të kaluarën: së pari, një lloj sigurie e arsyeshme për datën e zgjedhjeve do të ishte e dobishme, pasi kjo ndikon në hierarkinë e afateve kohore për përgatitjen e procesit zgjedhor; së dyti, nevojiten përmirësime të mëtejshme në dispozitat për listat e zgjedhësve. Ministria e Brendshme, me mbështetjen tonë, ka filluar të diskutojë për përgatitjet me kryetarët e bashkive/komunave dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Më tej, duhen riparë dispozitat për komisionet zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, si përsa i përket përbërjes, ashtu edhe funksionimit të tyre. Gjithashtu, duhet të rishikohen e përsosen edhe procedurat e numërimit dhe të nxjerrjes së rezultateve. Ka vend edhe për përmirësimin e efektshmërisë së procedurave të apelimit ndaj vendimeve të administratës zgjedhore.

Zyra që ju përfaqësoni kishte kohët e fundit mospërputhje qëndrimesh me Bashkimin Evropian. Konkretisht, Prezenca u shpreh që çështja e Zogut të Zi mund të ndikonte në negociatat me BE-në, ndërsa Ambasadori Salzman n nuk mendonte kështu. Pse ndodhi kjo?

Ne nuk e kemi thënë këtë, por nëse doni t'i ktheheni kësaj çështjeje, le t'i kthehemi. Është fakt jetësor që zhvillimet në vend, sidomos kur flasim për probleme qeverisjeje, janë të prirura që, në një mënyrë apo një tjetër, të ndikojnë tek ambiciet për integrim. Është tjetër gjë nëse polemika rreth Zogut të Zi në veçanti dhe problemeve që lidhen me të ndikojnë apo jo negativisht në interesat e jashtme të Shqipërisë dhe përsëri është çështje tjetër nëse Prezenca e OSBE-së duhet të shprehej në lidhje me të. Unë them se gjykimet mbi çështjet që lidhen me BE-në nuk janë gjykimet tona dhe ne ia kemi shpjeguar këtë palëve të interesuara, si palës shqiptare ashtu edhe asaj ndërkombëtare. Kjo është gjithçka që mund të them për këtë, të paktën, unë.

Cila është perspektiva e monitorimit të Shqipërisë nga Prezenca? Sa do të zgjasë ky monitorim?

Ne nuk kemi për detyrë të monitorojmë. Është një mision tjetër ndërkombëtar këtu në Shqipëri, emri i të cilit e përmban nocionin e monitorimit. Sigurisht që ne duhet t'i ndjekim zhvillimet që kanë të bëjnë me fushat ku ne ofrojmë asistencë në përputhje me mandatin që kemi. Pa bërë këtë, ne do të vepronim në izolim dhe nuk do të dinim se çfare ndodh përreth nesh. Në këtë pikëpamje, ne bëjmë thjesht atë që bëjnë edhe organizata të tjera ndërkombëtare që ndihmojnë Shqipërinë. Sa kohë do të qëndrojë Prezenca këtu? Aq kohë sa qeveria shqiptare dhe 54 vendet e tjera anëtare të OSBE-së ta konsiderojnë qëndrimin e saj të dobishëm.

Së fundi, disa eksponentë të politikës e kanë kritikuar ashpër Prezencën e OSBE-së për tejkalim kompetencash për sa i përket rolit të saj në disa çështje të ndjeshme të politikës. Sabri Godo shkoi deri atje sa kërkoi që të ndryshojë mënyra e funksionimit të Prezencës. Cila është përgjigjja juaj ndaj këtyre kritikave?

Askush nuk ka imunitet ndaj kritikave, por ato duhen mbështetur në fakte. Unë, thjesht, nuk mendoj se ne kemi dalë jashtë mandatit tonë.